

L I G J
Nr. 8113, datë 28.3.1996

PËR DEKORATAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
(Ndryshuar me ligjet; nr. 8765¹, datë 2.4.2001; nr. 8971, datë 14.11.2002)
(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16 e 28 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Presidentit të Republikës

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
(Shtuar togfjalësh me ligjin nr. 8765, datë 2.4.2001)

Dekoratat e nderit u jepen shtetasve shqiptarë ose të huaj, si dhe personave juridikë, që shquhen për merita të veçanta ndaj Republikës së Shqipërisë dhe interesave kombëtare.

Neni 2

Dekoratat jepen nga Presidenti i Republikës.

Neni 3
(Ndryshuar pika 4, shtuar pika 11 me ligjin nr. 8765, datë 2.4.2001; shtuar pika 12 me ligjin nr. 8971, datë 14.11.2002)

Presidenti i Republikës jep këto dekorata:

1. Urdhri i Flamurit Kombëtar
2. Urdhri "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"
3. Urdhri "Nderi i Kombit"
4. Urdhri "Mjeshtër i Madh "
5. Urdhri "Nënë Tereza"
6. Urdhri "Naim Frashëri"
7. Medalja e Artë e Shqiponjës
8. Medalja "Martir i Demokracisë"
9. Medalja "Pishtar i Demokracisë"
10. Medalja "Për Shërbime Ushtarake"
11. Medalja “Për Merita të Veçana Civile
12. Medalja e Mirënjohjes.

¹ Ligji nr. 8765, datë 2.4.2001 në nenin 5 shprehet;

“Urdhri “Mjeshtër i Madh i Punës”, i dhënë deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, njihet si Urdhri “Mjeshtër i Madh”.

Neni 4

Përshkrimi i dekoratave, rregullat dhe procedurat për propozimet dhe shqyrtimin e tyre caktohen nga Presidenti i Republikës.

KREU II MOTIVACIONET DHE KUSHTET E DHËNIES SË DEKORATAVE

Neni 5

Urdhri i Flamurit Kombëtar

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për merita të jashtëzakonshme për lartimin e kombit shqiptar dhe të Shqipërisë. Ky urdhër do të jetë i artë.

Neni 6

Urdhri "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për ndihmesë të qenësishme ose akte të veçanta heroike në mbrojtjen, forcimin e përparimin e Republikës së Shqipërisë. Ky urdhër do të jetë i artë.

Neni 7

Urdhri "Nderi i Kombit"

U jepet qytetarëve shqiptarë që me veprat dhe emrin e tyre nderojnë kombin shqiptar brenda dhe jashtë vendit. Ky urdhër do të jetë i artë.

Neni 8

Urdhri "Mjeshtër i Madh "

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 8765, datë 2.4.2001)

U jepet punonjësve të fushave të ndryshme të shkencës, artit, sportit, drejtimit, prodhimit dhe biznesit për punë të shquara. Ky urdhër do të jetë i artë.

Neni 9

Urdhri "Nënë Tereza"

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për akte të shquara humanizmi ndaj kombit shqiptar dhe njerëzimit. Ky urdhër do të jetë i artë.

Neni 10

Urdhri "Naim Frashëri"

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj, punonjësve të shkencës, artit, kulturës dhe arsimit për vepra dhe veprimtari të çmuara. Ky urdhër do të jetë i artë dhe i argjendtë.

Neni 11

Medalja e Artë e Shqiponjës

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për trimëri në luftën e armatosur dhe për

veprimtari ose akte të guximit qytetar në kohë paqeje. Kjo medalje do të jetë e artë.

Neni 12

Medalja "Martir i Demokracisë"

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj, që janë martirizuar për veprimtarinë e tyre të shquar për lirinë, demokracinë dhe përparimin shoqëror të Shqipërisë dhe të kombit shqiptar. Kjo medalje do të jetë e artë.

Neni 13

Medalja "Pishtar i Demokracisë"

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për shërbime të shquara e sakrifica të kryera për kombin shqiptar dhe demokracinë. Kjo medalje do të jetë e artë.

Neni 14

Medalja "Për Shërbime Ushtarake"

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për merita të veçanta në shërbimin ushtarak në Shqipëri. Kjo medalje do të jetë e artë.

Neni 14/1

Medalja "Për Merita të Veçanta Civile"

(Shtuar me ligjin nr. 8765, datë 2.4.2001)

U jepet qytetarëve shqiptarë dhe të huaj për merita të veçanta civile në Shqipëri. Kjo medalje do të jetë e artë.

Neni 14/2

Medalja e Mirënjohjes

(Shtuar me ligjin nr. 8971, datë 14.11.2002)

Kjo medalje u jepet qytetarëve shqiptarë ose të huaj, në raste festash zyrtare dhe ngjarjesh historike. Medalja të jetë e artë.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Dhënia e dekoratave mund të shoqërohet me një shpërblim në të holla, sipas kriterëve që do të caktojë Këshilli i Ministrave.

Neni 16

Dekoratat e dhëna deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji do të njihen.

Neni 17

Ligji nr.6133, datë 12.2.1980, si dhe çdo dispozitë tjetër që ka të bëjë me këtë ligj

shfuqizohet.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr. 1439, datë 2.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Sali Berisha**